

Silabusi i lëndës: **BAZAT E GJEOLGJISË**

Të dhëna bazike të lëndës			
Njësia akademike:	Fakulteti i Shkencave Matematike Natyrore		
Titulli i lëndës:	BAZAT E GJEOLGJISË		
Niveli:	Bachelor		
Statusi lëndës:	Obligative		
Viti i studimeve:	I/semestri I		
Numri i orëve në javë:	3+2		
Vlera në kredi – ECTS:	8		
Koha / lokacioni:	E mërkurë: 9.30-11.45, Dep. Gjeografisë, salla 1		
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. asoc. dr. Valbon Bytyqi		
Detajet kontaktuese:	valbon.bytyqi@uni-pr.edu , https://sites.google.com/a/uni-pr.edu/valbonbytyqi/		
Përshkrimi i lëndës	<p>Kursi Bazat e Gjeologjisë ofron njohuri të përgjithshme për shkencën e gjeologjisë, objektin, detyrat dhe metodat e saj. Në kuadër të lëndës do të zhvillohen njohuri në lidhje me kristalet, mineralet, shkëmbinjët. Tektonika e pllakave si teori e re dhe ndikimi i saj në format e shtruarjes së shkëmbinjve magmatikë, sedimentarë dhe metamorfikë. Poashtu, në kuadër të lëndës do të diskutohet për proceset gjeologjike të brendshme (magmatizmi, vullkanizmi, tërmetet) dhe të jashtme (alterimi, proceset e shpatit, veprimtaria gjeologjike e erës, akullnajave, ujërave rrjedhëse dhe nëntokësore, deteve, oqeanëve, etj.). Gjithashtu, në kuadër të lëndës do të diskutohet mbi gjeologjinë historike, fosilet, moshën relative dhe absolute, hartat dhe kolonat gjeologjike, etj.</p>		
Qëllimet e lëndës:	<p>Programi mësimor i lëndës Bazat e gjeologjisë ka për qëllim që të zhvilloj aftësi për të njohur dhe kuptuar problemet e dinamikës së përgjithshme gjeologjike, proceset e brendshme dhe të jashtme në Tokë, mineralet e shkëmbinjët, botën organike të zhdukur (fosilet) si të zhvillimit të kores së Tokës dhe të gjitha ndryshimeve të cilat ajo i ka kaluar prej krijimit të saj e gjerë më sot.</p>		
Rezultatet e pritura të nxënies:	<ul style="list-style-type: none"> • Të shpjegoj origjinën e Tokës dhe karakteristikat kryesore gjeofizike, gjeokimi e gjeodezike të saj • Të identifikoj veçoritë e mineraleve dhe shkëmbinjve • Të shpjegoj funksionin e proceseve të brendshme gjeologjike dhe proceseve mineralformuese • Të interpretoj proceset e jashtme gjeologjike duke shpjeguar edhe vrojtimit që i bën në terren. • Të kuptoj procesin e krijimit të strukturave themelore të Tokës • Të kuptoj rolin e fosileve dhe marrëdhënieve ndërmjet shkëmbinjve në interpretimin e moshës relative të shkëmbinjve. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45

Ushtrime teorike/ laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/ konsultimet	10/semestër		10
Ushtrime në teren	10/semestër		10
Kollokuiume, seminare	30/semestër		30
Detyra të shtëpisë	15/semestër		15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	4	15	60
Përgatitja përfundimtare për provim	20/semestër	-	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	15		15
Projektet, prezantimet, etj.	10		10
Totali			250 orë
Metodologjia e mësimdhënies:	Ligjërata tradicionale, mësim interaktiv me studentin në qendër, punë në grupe, diskutim, debate. Për ilustrim dhe përforcim të fakteve dhe koncepteve do të zgjedhën fotografi, ilustrime të ndryshme. Daljet në terren në të cilat do të ushtrohet njohja e karakteristikave të terrenit		
Metodat e vlerësimit:	40% vlerësimi i parë (java 8) 10% aktivitete në klasë, vijim i rregullt, detyrë seminari 50% provim final.		
Literatura			
Literatura bazë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Prifti, K., Bejtja, P.: Gjeologjia e përgjithshme, Tiranë, 1996 2. Ziu, T. – Bazat e Gjeologjisë (tekst mësimor për degën e gjeografisë), Pegi, Tiranë, 2014 3. Lutgens, Tarbuck, Tasa: Essentials of Geology, 11th ed., Prentice Hall, 2011 4. Grotzinger, J., Jordan, T. – Understanding Earth, 7th, 2014. 		
Literatura shtesë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Carlson, Plummer, Hummersley: Physical Geology, Earth revealed, McGraw-Hill, 2011 2. Pruthi, V. – Gjeologjia (dispensë për studentë), Prishtinë. 		

Plani i dizajnuar i mësimit - Ligjëratat:		
Data:	Java	Ligjërata që do të zhvillohet
18.9.2024	I	Gjeologjia: objekti, detyrat dhe metodat e studimit
25.9.2024	II	Karakteristikat e përgjithshme gjeodezike, gjeofizike e gjeokimike të Tokës dhe ndërtimi i saj
2.10.2024	III	Kristalet dhe mineralet
9.10.2024	IV	Shkëmbinj të
16.10.2024	V	Format e shtruarjes së shkëmbinjve
23.10.2024	VI	Tektonika e pllakave
30.10.2024	VII	Magmatizmi dhe vullkanizmi
6.11.2024	VIII	Tërmetet dhe lëvizjet tektonike të kores së Tokës
13.11.2024	IX	Alterimi, proceset e shpatit, veprimtaria gjeologjike e erës
20.11.2024	X	Veprimtaria gjeologjike e ujërave rrjedhëse sipërfaqësore
27.11.2024	XI	Veprimtaria gjeologjike e akullnajave dhe ujërave nëntokësore
4.12.2024	XII	Veprimtaria gjeologjike e deteve dhe oqeanëve, liqeneve, kënetave
11.12.2024	XIII	Gjeologjinë historike – kuptimet themelore, metodat e përcaktimit të moshës relative e absolute
18.12.2024	XIV	Evolucioni gjeologjik i Tokës gjatë erës paleozoike, mezozoike, kenozoike
25.12.2024	XV	Hartat dhe profilet gjeologjike; kolonat stratigrafike

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
Vijimi i rregullt në ligjëratat dhe ushtrime është i obliguar si dhe respektimi i rregullave të mirësjelljes: mbajtja e qetësisë në mësim, shkyçja e telefonave celular, hyrja në sallë me kohë, etj.

**Mësimdhënësi i lëndës:
Prof.asoc.dr. Valbon Bytyqi**